

320 milionë euro investime,
Behgjet Pacolli: Grupet kriminale po bllokojnë Aeroportin e Vlorës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KURTI: PAS CERTIFIKIMIT TË REZULTATEVE DO T'I FILLOJ KOMUNIKIMET PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5



Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar të martën se, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme që u mbajtën më 7 qershor, do t'i fillojë komunikimet me partitë politike me

synim arritjen e një marrëveshjeje për formimin e institucioneve të reja. Ndërkaq profesori i së Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka vlerësuar se zgjedhja e presidentit apo presidentes së Kosovës duhet të

jetë prioritet pas konstituimit të Kuvendit, më pas të formohet qeveria. Ai ka paralajmëruar se moszgjedhja e kreut të shtetit brenda afatit kushtetues prej 60 ditësh do ta çonte vendin në zgjedhje të reja

TERMOCENTRALET E VJETRUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR NDOTIN 6.6 HERË MBI LIMITIN E LEJUAR F. 3



RAPORTI I GAP-it: VARËSIA NGA QYMYRI DHE CBAM MBETEN SFIDAT KRYESORE PËR KOSOVËN F. 3




OPINION

SHKATËRRUESIT E KOSOVËS ZBARKOJNË NË SHOQIPËRI F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



IRANI DHE SHBA-JA SHOHIN PËRPARIM DREJT PAQES F. 2

VETERANËT E UÇK-së U BËJNË THIRRJE PROTESTUESVE NË TIRANË: MOS I KEQPËRDORNI SIMBOLET E UÇK-së PËR QËLLIME POLITIKE F. 6

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI MERR PJESË NË CEF FORUM 2026 PËR QEVERISJEN, LEADERSHIPIN DHE QËNDRUESHMËRINË INSTITUCIONALE F. 8

SPORT



FFK-ja THEMELON AKADEMINË E REFERIMIT TË KOSOVËS F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

IRANI DHE SHBA-ja SHOHIN PËRPARIM DREJT PAQES



WASHINGTON, 23 QERSHOR - Irani dhe Shtetet e Bashkuara thonë se ka përparim në bisedimet për një marrëveshje të paqes, por deklaratat e tyre tregojnë se negociatat mbeten të brishta. Disa orë pasi nënpresidenti amerikan JD Vance u largua nga Zvicra më 22 qershor, pas bisedimeve që, sipas tij, sollën “përparim të mirë”, presidenti Donald Trump paralajmëroi Teheranin se do të veprojë nëse nuk respekton marrëveshjen me Uashingtonin. “Nëse Irani nuk i përmbahet marrëveshjes, ose nëse nuk silllet siç duhet, do të bëj atë që duhet të bëj”, u tha Trumpi gazetarëve në Uashington.

Vance tha se është bërë përparim drejt kornizës së një marrëveshjeje përfundimtare për paqe brenda 60 ditësh. Ajo përfshin garanci për kalim të sigurt në Ngushticën e Hormuzit, përfundimin e luftimeve në Liban dhe pranimin e vizitave të inspektorëve ndërkombëtarë bërthamorë nga ana e Iranit. “Kemi vendosur një themel shumë të mirë për një marrëveshje përfundimtare të suksesshme”, u tha Vance gazetarëve më 22 qershor, në resortin Burgenstok në Zvicrën qendrore, pas bisedimeve që zgjatën gjatë gjithë natës. “Marrëveshja përfundimtare është shtëpia. Ne kemi vendosur themelet; nuk e kemi ndërtuar ende shtëpinë, por kemi hedhur një bazë të mirë për të arritur një rezultat të favorshëm për popullin amerikan”, tha ai.

Këto themele duket se janë mjaftueshëm të forta, pasi

Uashingtoni njoftoi se i ka lejuar Iranit të prodhojë dhe shesë naftë në tregjet ndërkombëtare. “Në përputhje me bisedimet produktive në Zvicër, Irani është zotuar për transit të lirë dhe të hapur në Ngushticën e Hormuzit. Ai, po ashtu, do t’i lejojë inspektorët e Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) të kenë qasje në vend”, shkroi sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, në rrjetin X më 22 qershor. “Si pjesë e kësaj kornize, Thesari ka lëshuar një leje të përkohshme 60-ditore që autorizon prodhimin, dërgimin dhe shitjen e naftës iraniane”, shtoi ai.

Ndërkohë, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, pritet t’i vizitojë Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajtin dhe Bahrejnin këtë javë, në vizitën e tij të parë zyrtare në Gjirin Persik që nga shpërthimi i luftës me Iranin, më 28 shkurt.

Misioni diplomatik synon t’i sigurojë aleatët rajonalë për qasjen e ShBA-së ndaj Iranit.

Edhe Irani e vlerësoi pozitivisht raundin e bisedimeve.

Negociatori kryesor iranian dhe kryetari i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, tha për televizionin shtetëror se Teherani ka rënë dakord për krijimin e një linje komunikimi lidhur me kalimin e anijeve në Ngushticën e Hormuzit. Ai shtoi se gjatë bisedimeve është finalizuar edhe një marrëveshje për lirin e 12 miliardë dollarëve asete të ngrira iraniane.

Edhe pse nuk u dhanë shumë hollësi konkrete, marrëveshja duket se bazohet në objektivat e

përgjithshme të memorandumit të mirëkuptimit (MOU) që ShBA-ja dhe Irani nënshkruan javën e kaluar.

Ky dokument i la të paqarta shumë nga pikat e marrëveshjes me 14 pika, duke i lënë ato për t’u sqaruar më vonë.

Vance tha se Irani ka pranuar t’i rikthejë inspektorët bërthamorë ndërkombëtarë dhe se palët janë duke punuar për një mekanizëm që siguron kalim të lirë në Ngushticën e Hormuzit dhe pastrimin e zonës nga minat, për të shmangur problemet në furnizimin global me energji.

Ndërmjetësit nga Katari dhe Pakistani thanë se rundi i parë i bisedimeve ka përfunduar, por se diskutimet teknike do të vazhdojnë javën e ardhshme.

Ata shtuan se do të krijohen grupe pune për çështjet bërthamore, sanksionet dhe një mekanizëm për monitorim dhe zgjidhje mosmarrëveshjesh, për të siguruar zbatimin e marrëveshjes.

Heqja e bllokadës

Ministria e Jashtme e Iranit, përmes deklaratave të raportuara nga media shtetërore iraniane, tha se është hequr një bllokadë amerikane ndaj porteve, janë liruara “disa asete të ngrira” dhe është nisur një “plan i madh zhvillimor për rindërtimin e Iranit”.

Një zëdhënës i ministrisë tha se, për kalimin e sigurt të anijeve në Ngushticën e Hormuzit, është rënë dakord për krijimin e një mekanizmi, por nuk dha më

shumë detaje.

Delegacionin amerikan në negociatën e udhëhoqën Vance, i dërguari special, Steve Witkoff, dhe dhëndri i presidentit Trump, Jared Kushner.

Delegacionin iranian e udhëhoqën kryetari i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, dhe ministri i Jashtëm, Abbas Araçchi.

Sipas deklaratës së ndërmjetësve, duke u bazuar në memorandumet e mëhershme mes Uashingtonit dhe Teheranit, palët janë pajtuar për krijimin e një komiteti të nivelit të lartë që do të mbikëqyrë procesin politik të ndërmjetësimit.

Po ashtu, është krijuar një “linjë komunikimi” për periudhën 60-ditore për të shmangur incidentet dhe keqkuptimet, me qëllim sigurimin e kalimit të sigurt të anijeve tregtare në Ngushticën e Hormuzit.

Gjithashtu, do të krijohet një “qelizë dekonflikti” me pjesëmarrjen e ShBA-së, Iranit dhe Libanit, për të siguruar përfundimin e operacioneve ushtarake në Liban, siç është paraparë në memorandum.

Uashingtoni është zotuar se do të lehtësojë krijimin e një fondi të rindërtimit prej 300 miliardë dollarësh, të mbështetur nga vendet e rajonit, sapo të arrihet një marrëveshje përfundimtare më e gjerë për programin bërthamor të Iranit.

Marrëveshja, dhe sidomos plani për krijimin e një fondi rindërtimi si dhe mungesa e qartësisë për programin bërthamor të Iranit, janë pritur me zemërim nga demokratët në ShBA, por edhe nga shumë

republikanë.

Vance iu përgjigj këtyre shqetësimeve duke thënë se, “nëse” fondet iraniane zhblllokohen ndonjëherë, ShBA-ja do të sigurohet që ato të përdoren për të ndihmuar popullin iranian dhe jo për të financuar terrorizmin. Ai shtoi se paratë do të shkonin për kompani amerikane që do të furnizonin Iranin me ushqime dhe mallra të tjera bazë.

Megjithatë, guvernatori i Bankës Qendrore të Iranit, Abdul Nasser Hemmati, u citua nga agjencia e lajmeve Tasnim të ketë thënë se Teherani nuk do të jetë i detyruar të blejë produkte bujqësore nga ShBA-ja dhe se fondet e zhbllokuara nuk do të përdoren domosdoshmërisht vetëm për blerje të mallrave esenciale.

Shumë udhëheqës izraelitë kanë shprehur, po ashtu, dyshime për disa pjesë të bisedimeve, duke theksuar se Izraeli nuk është palë në marrëveshje, dhe janë zotuar se do t’i vazhdojnë sulmet ndaj objektivave të Hezbollahut në Liban.

Hezbollahu - grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe të jugut të Libanit dhe që mbështetet nga Irani - konsiderohet organizatë terroriste nga ShBA-ja, ndërsa BE-ja ka vendosur sanksione vetëm kundër krahut të tij ushtarak, jo atij politik.

Disa raporte sugjerojnë, gjithashtu, se rezistenca nga disa fraksione të ashpra brenda Iranit - përfshirë Gardën Revolucionare Islamike - ka shtuar presion mbi ekipet negociuese të Teheranit.

320 MILIONË EURO INVESTIME, BEHGJET PACOLLI: GRUPET KRIMINALE PO BLOKOJNË AEROPORTIN E VLORËS

VLORË, 23 QERSHOR - Biznesmeni Behgjet Pacolli ka reaguar ashpër lidhur me situatën në kantierin e Aeroportit të Vlorës, duke pretenduar se grupe kriminale kanë bllokuar sërish qasjen në aeroportin ku, sipas tij, kompania "Mabco" ka investuar mbi 310 milionë euro.

Në "Facebook", Pacolli i ka bërë thirrje Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) që t'i fillojë hetimet sa më shpejt, duke ngritur shqetësime për

atë që e cilëson si pengim të një aktiviteti të ligjshëm përmes rojeve private, mjeteve të rënda dhe vetëgjyqësisë. "Grupet kriminale prapë kanë bllokuar aksesin në Aeroportin e Vlorës, ku Mabco ka investuar mbi 310 milionë euro! Apelojmë te SPAK-u që të fillon hetimin e thellë. Nuk është çështje konflikti, është çështje më e thellë. A është krim bllokimi i një aktiviteti të ligjshëm me roje private, mjete të rënda dhe vetëgjyqësi? Nëse po, pse nuk po vepron askush? Nëse secili

në këtë vend mund të marrë disa roje private, të bllokojë hyrje-daljet, të pengojë zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe të imponojë vullnetin e tij me forcë, atëherë a jetojmë në Republikën e Shqipërisë apo në Republikën e Rojeve Private? Çfarë roli kanë rojet private në këtë vend? Si është e mundur që një kompani private të vendosë se kush hyn dhe kush nuk hyn në një kantier, pavarësisht vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, pavarësisht vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe pavarësisht



kërkesave të institucioneve shtetërore? Si është e mundur që një kompani sigurie private të bllokojë fizikisht hyrjen në një aset strategjik kombëtar dhe askush të mos mbajë përgjegjësi?", ka shkruar Pacolli në "Facebook".

Ai ka thënë se nëse çdo kompani në Shqipëri mund të marrë disa roje private, të vendosë kamionë në hyrje dhe të shpallë veten mbi ligjin, atëherë: "Për çfarë na duhen gjykatat? Për çfarë na duhen institucionet? Për çfarë na duhet shteti? Sot nuk po diskutojmë më për një konflikt biznesi. Sot po diskutojmë për ekzistencën e shtetit ligjor. Sot është vënë në pikëpyetje

autoriteti i shtetit. Sot shtrohet pyetja themelore: a zbatohen vendimet e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë apo jo? Sepse, nëse një vendim i formës së prerë i Gjykatës mund të bllokojë nga një grup njerëzish me kamionë dhe roje private, atëherë problemi nuk është më Aeroporti i Vlorës. Problemi është vetë shteti ligjor. Prej muajsh, Mabco po përballet me pengesa të vazhdueshme dhe të papranueshme. Prej javësh po shohim vandalizëm, bllokime, dëmtime të pronës dhe pengim të punimeve", ka thënë Pacolli.

Ai ka thënë se sot po shohin

moszbatim të hapur të ligjit para syve të të gjithëve, si dhe privim të së drejtës për veprim dhe lëvizje. "Ku janë institucionet që duhet t'u japin përgjigje qytetarëve? Kjo nuk është më një çështje vetëm e Mabco-s apo e 2A-së. Kjo është një çështje që prek çdo qytetar. Kush i zbaton ligjet në këtë vend? Ligjin për shoqëritë tregtare? Vendimet e Gjykatës së Lartë? Apo rojet private?", ka shkruar Pacolli. Pas këtij postimi të Pacollit, pas një ore, punëtorët e "Mabco"-s kanë hyrë në Aeroportin e Vlorës, ku edhe ka nisur kontrolli i inventarit dhe përgatitjet për rifillimin e punimeve.



TERMOCENTRALET E VJETRUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR NDOTIN 6.6 HERË MBI LIMITIN E LEJUAR

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Tetë vjet pas hyrjes në fuqi të standardeve për kontrollin e ndotjes së ajrit sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, emetimet e ndotjes në Kosovë, Bosnjë- Hercegovinë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi janë 6.6 herë më të larta se niveli i lejuar, thuhet në raportin e ri të Bankwatch-it.

Bankwatch është rrjeti më i madh i organizatave mjedisore dhe shoqatave për të drejtat e njeriut në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Raporti, i titulluar "Përputhu ose mbyll", u publikua më 23 qershor dhe trajton moszbatimin e ligjeve për emetimet e dyoksidit të squfurit (SO₂) nga termocentralet e vjetruara me qymyr në Ballkanin Perëndimor, të cilat, vitin e kaluar, i kanë tejkaluar kufijtë ligjorë, raporton REL.

Në të njëjtën kohë është rritur edhe ndotja nga pluhuri, duke arritur nivelin më të lartë që nga hyrja në fuqi e rregullave

aktuale në vitin 2018.

Termocentralet me qymyr në Bosnjë-Hercegovinë kanë qenë emetuesit më të mëdhenj të SO₂, me 196 940 tonë, që është 12.7 herë mbi kufirin e lejuar.

Pas saj renditet Serbia me 177 756 tonë, ose 5.1 herë mbi nivelin e lejuar.

Në të gjithë rajonin, emetimet e SO₂ janë ulur vetëm në mënyrë të lehtë që nga viti 2018.

Kufijtë e emetimeve në vitin 2025 janë bërë edhe më të rreptë se në vitet e mëparshme - gjë që ka çuar në shkelje edhe më të mëdha, thuhet në raportin e Bankwatch-it.

Ndotësi më i madh i SO₂ në vlera absolute mbetet termocentrali Uglevik në Bosnjë-Hercegovinë, edhe pse ai ka pajisje për desulfurizim.

Emetimet në vitin 2025, me 115 079 tonë, kanë qenë më të lartat që nga hyrja në fuqi e rregullave për kontrollin e ndotjes në vitin 2018.

Ndotja nga pluhuri ka qenë 2.9 herë më e lartë se niveli i lejuar



në vitin 2025, duke arritur nivelin më të lartë absolut dhe relativ që nga fillimi i zbatimit të rregullave më 2018.

Kjo është nxitur kryesisht nga një rritje e madhe në termocentralin e Manastirit në Maqedoninë e Veriut, i cili ka dyfishuar emetimet krahasuar me vitin 2024.

Vetëm ai ka emetuar më shumë se 7 094 tonë mbi kufirin e lejuar për të gjithë rajonin.

Gacko në Bosnjë-Hercegovinë mbetet gjithashtu emetuesi më i

madh relativ i pluhurit. Pavarësisht një rënije të lehtë krahasuar me vitin 2024, ai ka emetuar 15.1 herë më shumë se niveli i lejuar.

Ashtu si në vitin 2024, emetimet totale të oksideve të azotit nga termocentralet në vitin 2025 kanë qenë 1.4 herë mbi kufirin e lejuar.

Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia kanë tejkaluar kufijtë ligjorë, ndërsa emetimin më të madh e ka pasur Nikolla Tesla B në Serbi - 11.247 tonë.

Termocentrali në Plevle në Mal të Zi ka kaluar nëpër një rikonstruksion në vitet e fundit dhe pjesën më të madhe të vitit 2025 nuk ka funksionuar. Megjithatë, nuk ka prova se ai është në përputhje me standardet e ndotjes që do t'i lejonin vazhdimin e operimit. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka hapur disa raste shkeljesh kundër vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke konfirmuar funksionimin e paligjshëm të termocentraleve të tyre me qymyr.

Megjithatë, asnjë qeveri nuk ka vendosur gjoba ndaj këtyre termocentraleve dhe nuk ka plane të qarta, të përditësuara dhe realiste për përputhje me rregullat apo mbyllje të tyre.

Nga janari i këtij viti ka hyrë në fuqi edhe Mekanizmi i BE-së për Rregullimin e Emisioneve të Karbonit (CBAM), i cili rrit koston e eksportit të energjisë elektrike dhe e bën edhe më pak fitimprurës prodhimin nga termocentralet me qymyr.



RAPORTI I GAP-it: VARËSIA NGA QYMYRI DHE CBAM MBETEN SFIDAT KRYESORE PËR KOSOVËN

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Instituti GAP, në kuadër të projektit "Politikat Industriale të Gjelbra (GIP)" të përkrahur nga Fondacionet e Shoqërisë së Hapur - Ballkani Perëndimor (OSF-WB), organizoi tryezën e diskutimit ku paraqiti raportin "Politikat Industriale të Gjelbra: Analizë e Kontekstit të Kosovës".

Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv në Institutin GAP, theksoi rolin udhëheqës të GAP-it në koordinimin e këtij projekti prej mbi tri vitesh, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile në vendet e tjera të rajonit. Ai vuri në dukje se bashkëpunimi ndërballkanik mund të sjellë ndikime dhe përfitime shumë më të mëdha, duke shtuar se raportit shkon thellë në ekonominë vendore dhe paralajmëron kostot e mundshme ekonomike të mosveprimit, veçanërisht në lidhje me taksën e karbonit (CBAM) të BE-së, e cila është në zbatim nga fillimi i këtij viti.

Dritan Nelaj, drejtues i Programit për Tranzicion të Drejtë të Energjisë në Fondacionet për Shoqëri të Hapur - Ballkani Perëndimor, theksoi se tensionet gjeopolitike globale, konkurrenca strategjike mes ShBA-së dhe Kinës, si dhe zhvillimet teknologjike dhe të

inteligjencës artificiale po e bëjnë mjedisin ekonomik gjithnjë e më kompleks.

Ai nënvizoi se politikat e gjelbra të Bashkimit Evropian nuk duhet të shihen si kërcënim, por si një mundësi për Kosovën që ta përgatitë ekonominë e saj për të ardhmen dhe të veprojë në mënyrë më proaktive.

Rrona Zhuri nga Instituti GAP paraqiti gjetjet kryesore të raportit, duke theksuar se Kosova vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme në tranzicionin e gjelbër, përfshirë varësinë e lartë nga qymyri, ritmin e ngadaltë të zhvillimit të energjisë së ripërtërishme, ndikimin e Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit për Karbon (CBAM) në industrinë vendore dhe nevojën për investime të konsiderueshme në sektorin energjetik. Ajo theksoi se Politikat Industriale të Gjelbra gjithëpërfshirëse mund të ndihmojnë në lidhjen e tranzicionit energjetik me zhvillimin ekonomik, rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë vendore, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përafrimin e Kosovës me objektivat klimatike dhe energjetike të Bashkimit Evropian.

Ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, theksoi se investimet në kapacitete të reja të burimeve të ripërtërishme dhe në efikasitet të energjisë, mbeten

prioritete kyçe të dekarbonizimit dhe tranzicionit të gjelbër të Kosovës. Ajo theksoi se lidhur me investimet aktuale në energji të ripërtërishme përmes ankandit solar dhe të erës, fillimisht është vendosur baza ligjore dhe rregullative për zhvillimin e tyre, e që do ta lehtësojë zhvillimin e projekteve të ardhshme. Rizvanolli, gjithashtu, theksoi se investimet në efikasitet të energjisë do të jenë të vazhdueshme.

Ajo potencoi nevojën për financim nga grantet dhe kreditë dhe rëndësinë e fondeve nga Bashkimi Evropian për financimin e projekteve të gjelbra.

Ndërsa ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, e veçoi rëndësinë e politikave industriale të gjelbra duke theksuar përpjekjet e MINTI për zgjerimin e skemave të granteve për biznese për investime të gjelbra, zhvillimin e parkut të parë ekoindustrial në vend, nxitjen e ekonomisë qarkore dhe forcimin e bashkëpunimit me institucione arsimore për të marrë kuadro nga fushat përgjegjëse në menaxhim të projekteve.

Kusari-Lila, gjithashtu, theksoi se MINTI përmes granteve për biznese për avancim teknologjik si dhe sesioneve informuese dhe asistuese për

llogaritje të emetimeve të karbonit, do ta lehtësojë gatishmërinë e bizneseve për përshatje me kërkesat e CBAM. Nga paneli i diskutimit, drejtori i Asociuar dhe Udhëheqësi për Kosovë nga BERZH-i, Sergiy Maslichenko, theksoi se BERZH-i është institucioni financiar ndërkombëtar më i madh në Kosovë, me financim prej rreth 120 milionë eurosh në vit, prej të cilave rreth 70 % janë të dedikuara për projekte të gjelbra, veçanërisht në energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë. Po ashtu, ai nënvizoi nevojën për përshtetimin e ankandëve solare dhe me erë, si dhe për rritjen e ritmit të investimeve për t'i ndjekur zhvillimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, u theksua rëndësia e forcimit të koordinimit institucional dhe krijimit të një platforme të centralizuar për menaxhimin e projekteve energjetike.

Kryeshefi i KOSTT-it, Trim Tërnavi, theksoi se operatori i transmisionit ka përgjegjësinë për balancimin në kohë reale të sistemit energjetik, në përputhje me detyrimet e rrjetit evropian. Ai bëri me dije se KOSTT-i ka realizuar investime që nga viti 2021, në bashkëpunim me donatorë dhe financues ndërkombëtarë, për modernizimin e rrjetit të transmisionit dhe kyçjen e kapaciteteve të reja.

Megjithatë, ai përmendi se rreth 50 % e kapaciteteve ekzistuese ndërkufitare të transmetimit dhe shpërndarjes mbeten të pashfrytëzuara. Po ashtu, KOSTT-i është duke zhvilluar një hartë interaktive për identifikimin e zonave të përshatshme për investime dhe kyçje në rrjet, për ta përmirësuar planifikimin e projekteve energjetike.

Drejtoresha menaxhuese e Fondit të Kosovës për Efikasitet të Energjisë, Njomza Hoxha, theksoi rëndësinë e investimeve në efikasitet të energjisë në sektorin publik dhe rezidencial, dhe tregoi se FKEE deri tani ka investuar rreth 40 milionë euro në masa të efikasitetit të energjisë, përmes financimit nga Qeveria e Kosovës, donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Përmes këtyre investimeve janë arritur kursime të energjisë deri në 25 GWh në vit. Për më shumë, ajo përmendi se Fondi do të vazhdojë të ofrojë skema të subvencionimit për shtëpi individuale dhe të investojë në ndërtesa shumëbanesore rezidenciale përmes bashkëpunimit me komuna dhe kombinimit të financimit edhe me sektorin bankar.

Në tryezën e diskutimit kontribuuan edhe përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave të huaja dhe lokale si dhe aktorë të tjerë.

SHKATËRRUESIT E KOSOVËS ZBARKOJNË NË SHQIPËRI



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Dyfytyrësia kurti (z) ane: Në këtë mbremje në Tiranë edhe sot, për herë të 23-të do të mbahen protesta në pamje për çështje mjedisore, siç janë ruajtja e Zvernecit dhe Lagunës së Nartës ndërsa, në fakt, është grushtshtet kundër KM të Shqipërisë, Edvin Ramës dhe kundër investimeve strategjike amerikane duke e identifikuar me familjen Tramp. Është një arsyetim thuaja cinik, thënë më së buti se qëllimi kryesor është mbrojtja dhe ruajtja e llojeve të shpezëve që karakterizojnë atë mjedis siç janë flamingot. Zverneci dhe Laguna e Nartës shërbyen vetëm si një pikënisje e një orteku shkatërrues ku përfshihen Sazani, Gjiri i Kakomësë, Rrjollit, Butrinti etj. Po bëhen përpjekje që të ndërtohet një Shqipëri e Re, si ajo e vitit 1997 në Vlorë ku u përmbysë rendi juridik dhe institucionet shtetërore u dogjën ose u braktisën. Rëndin dhe ligjin e caktonin bandat e Zani Çaushtit, banda e Gaxhait, banda e Mandelës (Eduard Peqini) etj. Edhe ata e donin një Shqipëri të Re - poskomuniste. Në Shqipëri, për herë të parë kam qenë në vitin 1990, me Hajrullah Ukën, një patriot i vendosur. Kemi hyrë kah Struga. Në atë kohë Shqipëria ka qenë në mjerimin më të thellë të mundur, e paimagjineshme dhe e pabesueshme për ata që kishin jetuar në rrethana tjera. Të verbër nga idealizmi dhe dashuria për Shqipërinë, nuk e pranionim këtë realitet. Në tërë Tiranën nuk gjeje vend për të fjetur apo për t'u ushqyer. Hotel "Dajti" dhe hotel "Tirana" ishin stëmbushur me të huaj edhe me ato pak kapacitete. Kemi paguar 20 DM për ta kaluar një natë ulur në një karrige. Turizmi në Durrës ishte zero. Në vitin 2000 kam shkruar për herë të parë në Sarandë ndërkaq që rruga, nga kufiri në Kukës ishte

tmerri vet. Pastaj Lushnje - Fier ishte pa një cm asfalt, plotë gurë dhe pluhur. Fier - Levan në rastin më të mirë kalohej për 1.5 deri 2 orë kurse tani kalohet për 10 minuta. Rruga Vlorë - Sarandë, buzë detit i ngjante relit Paris - Dakar. Saranda e asaj kohe kishte plotë portokalle, limonë, banane kurse shumë pak vende për vizitorë. Ishin hotel "Butrinti", "Grandi", "Sejko", "Delfini" dhe ca të tjerë. Që nga ky vit pushimet i kam bërë në Sarandë tek Beni - "Hotel Iliria" dhe në Ksamil, "te Guri". Pra, që nga viti 1990 jam dëshmitarë i gjallë i ecjes së Shqipërisë drejt përparimit dhe zhvillimit deri në kohën e "Revolucionit të flamengove". Dhe e them se në këtë periudhë 1990 - 2026, të gjitha shtetet e Ballkanit bashkë nuk janë zhvilluar sa Shqipëria e vetme! Në politikë nuk jam i majtë, e konsideroj veten nacionalist pozitiv dhe konstruktiv prandaj nuk kam pasur kurrfarë mendimi pozitiv për Enver Hoxhën. Nuk kam as për Sali Berishën, mendoj se si krypto komunist, më së shumti e ka dëmtuar demokracinë në Shqipëri. Nëse dikush ia ka ndryshuar fytyrën Shqipërisë, ai është Edvin Rama. Aktualisht në Shqipëri dhe Kosovë i kemi dy të krisur që kanë prirje dhe pushtet autoritar: Edvin Rama dhe Albin Kurthi. Edvin Rama është i krisur konstruktiv, Albin Kurthi është i krisur destruktiv. Në kohën kur Edvin Rama ndërton, Albin Kurthi shkatërron! Në kohën kur Shqipëria është anëtare thuaja e të gjithë mekanizmave ndërkombëtare dhe në prag të anëtarësimit në BE, Kosova nuk është asgjëkund! Me meritën e Albin Kurthit. Kur Edvin Rama fliste për shqiptarët e Luginës, Malit të Zi dhe në Maqedoni të Veriut nga pozita e një Piemonti (përbashkimi) cilësohej si patriot. Vetëm në Kosovë nga Kurthi (sidomos) dhe nga pjesëtarët e kombit të rremë kosovar, neojugosllavët dhe zagaret e Albinit sulmohej si paternalist. I mohoj dhe drejta të flasë në emër të Kosovës.

"Bashkimi kombëtar" i Albin Kurthit: Karemi kryesor mashtrues i Kurthit për të hyrë në politikë ishte bashkimi kombëtar. Kush nuk e donë

bashkimin përveç Nexhit, Halilit, Surroit, Gashit, Gjinovcit, atij që flet në emër të Kronikës së m...t, "prof. dr. Ramçe Llaskucit, Agim Paçurkës, Matoshkës dhe trushpëlarëve të tjerë të LV-së. Dejona Mihali është aktiviste e vendosur për bashkim kombëtar meGreqinë apo Serbinë në emër të Megali Idea dhe Velika Serbia. Kurthi çoi aktivistë në vrasje dhe vetëvrasje (Arben Xheladini dhe Mon Balaj), (Arbnor dhe Astrit Dehari) për ide, premtime dhe parime të cilat vetë i ka tradhtuar që të gjitha dhe cep më cep. Mashtruesi! Shiheni dallimin në ndërhyrje midis Edi Ramës dhe Albin Kurthit. Albin Kurthi ndërhyri në zgjedhje në Shqipëri përmes vazalëve sahanlëpirës si Dejona Mihali, Elpis Hoxha, Bojken Abazi dhe Hysamedin Ferraj me emrin artistik; Hys Ferri - Xhehnemi. Dhe dështoi! Në Luginë instaloi dyshen e rrogëtarëve, Ardita dhe Ragmia që më parë kishin dhe edhe sot marrin rrogë nga Hekuran pisi, përgjegjës i grazhdit të Albin Babës dhe 400000 hajnave. Në Mal të Zi e përkrahu "shqiptarin" çetnik, Dino Abazović që shqiptarët i solli në fund të pusit, po të mos ishte Milo Gjukanović, sa për Avazovićin dhe Kurthin do të mbetej Mali i Zi pa asnjë shqiptar. Në Maqedoni të Veriut, Kurthi me mikun që e ka për zemër, Hristijan Mickoski luftuan si armikun më të madh Ali Ahmetin dhe krahun e luftës duke e kriminalizuar luftën duke i zëvendësuar me Bekim Koçen, bilalla e izeta, gasha e dasha që janë më antishqiptarë se shovinistja Silanovka dhe racisti Mickoski. Rezultati i këtij barbarizmi antikombëtar të Kurthit është se shqiptarët, edhe ndonjë ditë do të mund ta përdorin lirisht gjuhën shqipe në komunikime private. Albin Kurthi po e ndihmon Botën Serbe në Maqedoni të Veriut duke e rrenuar identitetin dhe qenien shqiptarë! Dje, Edi Rama e mbrojti Kurthin duke deklaruar se ky i fundit nuk ka gisht e as dorë në këto protesta në kohën kur asnjë pordhë e vetme në LV nuk shkrepet pa lejen e Kurthit.

Kurthin e njoh që nga koha e paraluftës, e kam përkrahu shumë në kohën kur të gjithë ishin kundër tij. Edhe ata që ishin me te e që sot, ose janë larguar vet, ose janë përzënë nga Kurthi. E di shumë mirë edhe rastin e Binçes, edhe të Jelena Bjelicës ndërsa Ritën e njoh para se ta ketë takuar Kurthi. I di 100 për qind raportet e Kurthit me Bacën Adem. Prapaskanat dhe poshtërsitë. Edhe të vëllezërve Dehari. Edhe të kësaj antikombëtares Mihali. Dhe shumë të tjera që, nëse Zoti më jep jetë dhe mend, do t'i nxjerrë në dritë.

Me një reagim të një "defi të shqyer" por jo edhe nga Kurthi, u bë përpjekje që të distancohen nga pjesëmarrja e LV-së në këto protesta duke u arsyetuar se mund të ketë aktivistë të LV-së. Vërtetë Kurthi nuk ishte parë në protesta por ma thoni se kur ishte vet në Shqipëri herën e fundit? Edhe alter ego e Kurthit për të gjitha të zezat që po ndodhin në Kosovë, eminenca gri e korrupsionit, krimi të organizuar dhe antikombëtarizmit, Dejona Mihali po thotë se është vetëm një aktiviste ndonëse nuk lë vend pa i futur hundët! Gani Krasniqi, një patriot i devotshëm, me një idealizëm si relik i të kaluarës fort po e mbron këtë sekseren e Kurthit kurse babain e saj vetëm sa nuk e ka bërë zëvendës të komandantit legjendar, Adem Jashari. Aleksander Mihali ka kontribuar për UÇK-në për aq sa unë e kam ndihmuar Mao ce Dunin në Marshin e Madh Kinez kundër Qang aj Shekut.

Se qytetarët e Shqipërisë kanë drejtë të kërkojnë ndryshime është e padiskutueshme. Edhe përmes "Revolucionit të Flamengove". Mirëpo, në anën tjetër me çfarë të drejte qytetarët e Kosovës që në oborrin e tyre nuk e kanë asnjë pulë të vetme shprehin aq vullnet, pasion dhe përkushtim t'i mbrojnë flamingot ndonëse kurrë nuk i kanë parë. Secili, në rrethin ku jeton i njehë "mbrojtësit e flamengove" që në mënyrë të organizuar kanë zbarkuar në Tiranë, me të gjitha shpenzimet e mbuluara. Një numër i tyre për herë të parë kanë shkruar në Tiranë dhe Shqipëri, me mision për të shkaktuar trazira dhe

rrëzuar KM Rama dhe qeverinë e Shqipërisë sikur dikur bellogardistët e Vangelovit dhe xhandarët e Nikolla Pashiqit që përmbysën demokracinë e brishtë në Shqipëri për ta sjellur Zogun. Qytetarët e Kosovës apo viseve tjera ku jetojnë shqiptarët nuk kanë asnjë të drejtë të ndërhyjnë kundër institucioneve shqiptare aq më parë që askush nuk e kërkon nga ata që ta bëjnë këtë veprim. Ishin disa kokrra idiotësh që thirrnin për revolucion, mbase të haxhi Qamilit për t'i futur zjarrin Shqipërisë. Patriotët e vërtetë shqiptarë e duan Shqipërinë dhe i gëzohen çdo suksesi. "Mbrotjtësit e flamengove" nga Kosova nuk kanë asgjë patriotike dhe shqiptare, janë keqpërdorues të situatës dhe përfitues ordinerë. Albin Kurthi jo që nuk mund të lahet nga përgjegjësia për këtë ndërhyrje brutale në Shqipëri por sikur dikur Neroni do të kënaqet nëse Shqipëria përfshihet në një destabilizim kurthian. Nuk mund ta gjeni asnjë ushtar të UÇK-së që përkrahë destabilizimin e Shqipërisë as sot dhe asnjëherë! Edi Rama është arrogant, shpërfillës, mendjemadh mirëpo kurrë nuk do të punojë kundër shqiptarëve, Shqipërisë dhe Kosovës si dhe vendeve ku jetojnë shqiptarët. Prandaj nuk duhet të jep dorëheqje dhe nuk duhet ta lejojë kurtizimin e Shqipërisë. Nëse qytetarët e Shqipërisë duan ndryshime, qytetarët e Kosovës nuk kanë pse të ngatërrohen aq më parë që Kurthi me 400000 hajdutët e ka shndërruar Kosovën në tokë të djegur, vend të pajetueshëm dhe ku shpresës për një të ardhme më të mirë ia ka mbyllur të gjitha rrugët dhe mundësitë me qeverisje amatore dhe antikombëtare. Shqipëria duhet, ajo nuk luftohet sepse është rrënja, trangu dhe degëzimi i shqiptarisë. Degët mund të jenë në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Luginë apo në vende tjera por rrënjët dhe trangu ishin, janë dhe do të mbeten në Shqipëri. Po ku ka si ty moj Shqipëria ime... është himn i shpresës dhe jetës, gjenetikës shqiptare dhe vet ekzistencës. Rroftë Shqipëria!

Veteranët e UÇK-së u bëjnë thirrje protestuesve në Tiranë: Mos i keqpërdorni simbolet e UÇK-së për qëllime politike

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së shpreh publikisht shqetësimin për përpjekjet e vazhdueshme për manipulim politik dhe instrumentalizim të simboleve të UÇK-së në protestën disaditore në Tiranë. "Është e papranueshme dhe fyese për dinjitetin e luftës sonë që në emër të UÇK-së, të flasin dhe të paraqiten individë apo

grupe që për vite me radhë kanë tentuar ta zbehin, ta devijojnë dhe t'ia ulin vlerën luftës sonë çlirimtare. OVL e UÇK-së rithekson me përgjegjësi të plotë se kauza e UÇK-së nuk është dhe nuk mund të jetë instrument i asnjë agjende politike të ditës apo i interesave të ngushta personale e partiake. OVL e UÇK-së u bën thirrje organizatorëve të protestës në

Tiranë që ta garantojnë integritetin e protestës dhe të mos lejojnë asnjë përpjekje për manipulim, keqpërdorim apo vetëdeklarim të rremë në emër të ish-ushtarëve apo veteranëve të UÇK-së. UÇK-ja është pjesë e historisë së lirisë dhe sakrificës së popullit tonë dhe duhet trajtuar me respekt, jo për përfitime politike", është thënë në reagimin e OVL UÇK-së.



MIRËMËNGJES I DASHUR PROTESTUES: UNË JAM MIKU, JO ARMIKU YT



Shkruan: Edi RAMA

Nuk të shoh si humbësin e një proteste, po si njeriun e mbetur vetëm me bindjet e tij. Ti i je bashkuar vorbullës thithëse të turmës, sepse beson sinqerisht se po mbron diçka të çmuar.

Ndoshta ti ke frikë se vendi po shkon drejt humnerës. Kapitalistët e huaj do të gllabërojnë natyrën. Zogjtë e rrallë të Shqipërisë do të vdesin. Atdheu yt ka dalë në shitje.

Ose ndoshta ti nuk je i shqetësuar për zogjtë e as nuk e di fare ku bie tamam laguna e Nartës. Po mbase je i zemëruar ngaqë ke një hall tëndin. Hall pune me pronarin që të trajton si robot. S'të paguan orët jashtë orarit. Të jep gjysmën e rrogës në të zezë. Hall shëndeti në familje. Largqoftë me nënën e sëmurë që ka nevojë për ilaçe të shtrenjta. Hall prone me shtëpinë në periferi që ende nuk legalizohet apo me tokën në fshat që ende nuk regjistrohet...

Nuk e di çfarë halli ke tamam. Po di që ke një hall që jo vetëm nuk ta zgjidh askush, po as nuk ta qan kush. Besoje ose jo, po unë e ndjej brengën tënde. Sepse jo vetëm të kuptoj, po edhe të mirëkuptoj, ngaqë jam po aq i zemëruar sa ti me pronarin e pasur që kujton se pasuria i jep të drejtë të sillet si zot i fatit tënd. Me nëpunësin a me drejtorin që atij i shërben pa kushte, ndërsa ty as nuk të hedh sytë. Jam i zemëruar me arrogancën e kujtdo që detyrën ndaj teje e ushtron si pushtet mbi ty.

Por pikërisht sepse brenga jote më dhemb dhe arsyet e tua më gjejnë të bindur për legjitimitetin e tyre, unë nuk të shoh dot ashtu. Vetëm. Si një peshk jashtë ujit, pasi dallga e madhe që e nxori në breg është tërhequr e tëra. Dhe ata që të thirrën për t'u bërë "deti i Shqipërisë së re", pa pronarë arrogantë, pa nëpunës që i përulën lekut dhe përbuzin njeriun, pa halle shëndeti e pronash, pa të huaj që investojnë në tokat tona e pa investime private në brigjet tona, pa hiçasgjë që e cenon harmoninë e një vëllazërie të lumtur, sot nuk janë askund.

Ata që në studiot televizive të komentuan mbrëmë me entuziazëm si njeriu i popullit, që më në fund po lan hesapet me qeverinë dhe kryeministrin e korruptuar, ndërkohë që për vete, prej vitesh të gjata paguhen më shumë nën dorë se sa mbi dorë

për të shpifur tërë të zezat dhe sharë mua me libër shtëpie, tani po flenë në shtëpitë e bollshme të blera me ulje të forta nga "oligarkët". Mbi dyshekë të butë të blerë me "lëmoshat" e zeza mijëraeuroshe të këtyre të fundit. Ata që ranë nga kali i pushtetit në tërë këto vite dhe nuk e panë kurrë tek vetja po tek kali arsyen e rënies, e që gjetën tek ti dritën e shpresave të humbura duke të ngritur në qiell, po pinë me shoshoqin kafet e mëngjesit të herët. Mezi presin që ti sonte të jesh më i zemëruar, më i paduruar, më i çartur në protestën tënde kundër regjimit që i la pa kalë, pa roje, pa vartës. Shkurt pa shijen e pashoqe të pushtetit që sa më i kotë të jesh aq më shumë të mungon.

Influencerat, bloggerat e kullerat që të bënë të ndjehesh heroi i tyre, duke të dhënë për herë të parë në jetë ndjesinë dehëse të pushtetit që ka shpirti i luftëtarit të dalë nga radhët e popullit mbi të kamurit, të famshmit, të njohurit dhe pse jo, troç, edhe ndjesinë e fortë të mashkullit që si në një përrallë, u bë idhulli i femrave të paarritshme të botës së luksit, kanë fluturuar edhe ata larg, me krahët e orgazmës për vruillin e mbrëmshëm të lajkeve e të follouersave, të cilët hynë në gjinj të e në shalët e tyre si protestues, por tanimë do të mbeten në listën e tyre si klientë të reklamave për vilat, hotelet, kremrat, parfumet dhe brekët joshëse për sklevërit e algoritmit. Ikën edhe karvanet e "diasporës" nga Kosova e Tetova. Të përdorën ty, për të sjellë në Tiranë me vrazhdësinë brutale të hordhive pushtuese, mllefe politike sallahanash të pjesëve të tjera të kombit tonë. Kundër qeverisë tënde në Shqipëri, të cilën ti nuk je asfare i detyruar ta duash. Nuk je as i ndaluar ta luftosh. Por nuk ke as të drejtën të lejosh të tjerë të vendosin për të dhe të flasin në emrin tënd; djemtë e xhaxhallarëve dhe cucat e hallave, nuk vijnë dot në shtëpinë tënde për të vendosur.

Ikën sigurisht, edhe ata që algoritmi dhe partitë e partiçkat e gurëve të hedhur e të duarve të fshehura, i mblodhën për të burgosur Ramën duke e kthyer bulevardin e kryeqytetit të Evropës së Ballkanit, në një shesh mesjetar ku turmat e inkuizicionit ulërinin në kor për djegien e gjallë të shtrigave. Ikën qorrallapajt. Ikën ballibullistat. Ikën sypuliturat opozitare që të vinin rrotull duke folur me pasqyrën e tualetit digjital para fytyrës së tyre hipokrite. Ikën karikaturat parlamentare që nxirrnin kokën pas shqiponjës mbi kurrizin tënd...

Së bashku me armatat armike të profileve fallco e të raketave digjitale, që hidhen pa pushim

nga Lindja tutje Evropës drejt sheshit televiziv të revolucionit të flamingove dhe shpërndajnë në mijëra thërrime lajkesh e follouerash fallco, çdo bombë që gjuan një gënjeshtër, lajm të rremë, video të manipuluar, ikën edhe ata që u dyndën në bulevard nga emigracioni në shtete të huaja, si shqiponja shpëtimtare të mëmëdheut të nxjerrë nga algoritmi në sheshbetejën e kundërshtisë globale, politike, ideologjike me Presidentin e Amerikës.

Ikën të tërë!

Iku madje edhe një sorrë kobzeze, që predikonte hakmarrjen ndaj amerikanëve që vranë "vëllaun tonë", gjeneralin iranian Kasem Suleimani, kasapin e pamëshirshëm të regjimit terrorist të Teheranit. Ti mbete vetëm, me hallin tënd dhe pa askënd që ta qan, shëmbëlltyrë njerëzore e proletariatit të algoritmit, sepse algoritmi nuk ka ndjenja, nuk njuh njerëz, nuk do ideale, nuk pyet kush ka të drejtë. Ai interesohet vetëm për çfarë prodhon më shumë kuriozitet, eksitim, zemërim dhe varësi prej tij.

Ti në fakt mbete siç ishe. Ai që ishe kur u nise drejt bulevardit për të ndryshuar botën. I vetëm përballë ditës së gjatë. Me sytë e hapur në boshnjë që të rrethon, pas kthimit në tokë nga nata në qiellin e iluzioneve revolucionare. Ndërsa ata që u ngjitën lart në vëmendjen e dynjasë falë teje, duke të mbushur mendjen se befas u bërë ai që nuk je, forca e një revolucionit që nuk është, për përmbysjen e realitetit dhe zëvendësimin e tij me një realitet të krijuar vetëm për të të joshur ty, gatuan pa mëshirë në tiganin e pakufishëm të algoritmit, ushqimin e tyre me mishin e me shpirtin tënd.

Dhe u zhdukën.

Ti mbete aty.

Në këtë fotografi të trishtë unë nuk shoh assessi dështimin tënd.

Shoh veten time dhe vështirësitë e hallet e tua. Po, sepse luftoj përditë e zemërohem jo pak, me ata që nuk ua ndjen për ato vështirësi dhe jo nuk dinë as të t'i qajnë hallet, po më keq akoma, t'i përçmojnë si ti të ishe një koment anonim në fejsbukun e tyre, jo një rob Zoti me barrën e problemeve të tua në pragun e derës së shtetit tënd.

Por shoh tek kjo fotografi e zgjimit në sheshin e zbrazët edhe shijen e tradhtisë së gjithkujt që të përdori mbrëmë për interesat e veta. Ji i sigurt se sado e çuditshme të të duket, më ndodh edhe mua të kem zgjime të zbrazëta me të njëjtën shije. Po njësoj, fotografia është e imja ndërsa tradhtia është e të tjerëve, herë një bashkëpunëtor, herë një vartës i njohur a të tjera herë vartës të panjohur të vartësve, që për interesat e tyre e përdhunojnë besimin tim në formë të ndryshme. Sillen keq me njerëzit. Përçmojnë meritën. Stimulojnë farefisin. Promovojnë tarafin. Kërkojnë lekë nën dorë. Favore. E mbi të gjitha, harrojnë që ajo karrige është nder, jo uturak. Fatmirësisht, ndryshe nga ti, dita ime vazhdon me punë të pandalur, falë energjisë së mirë të plot e plot të tjerëve, që punojnë bashkë me mua.

Pra siç e sheh, kjo e imja nuk është letra e dikujt që të qan hallin duke të parë nga lart apo nga larg. Është një letër e ndjerë respekti për ty që besove, luftove dhe mbete vetëm. Po njëkohësisht është edhe një shtrirje dore nga dikush që e di ç'domethënë të ndjehesh vetëm, kur besimi që jep shpërdorohet dhe lufta që bën tradhtohet. E di që sot mund të më shohësh si kundërshtarin tënd. Ndoshta edhe si shkakun e zemërimit tënd. Kjo letër nuk është një përpjekje që ti të më shohësh ndryshe. As një kërkesë që ta drejtosh gjatë shigjetën e zemërimit tënd.

Pyete vetë veten nëse armiku yt jam unë, që përpiqem pa pushim

mes një mijë vështirësish që Shqipëria të bëhet çdo ditë më e mirë se një ditë më parë, apo ata që të kthyen në heroin e mbrëmjes për të të lënë në rrugë, vetëm, si shishe boshe të hedhur tutje pa kokëçarje pas një dehjeje kolektive.

Nëse përgjigja jote do të jetë akoma se armiku yt jam unë, patjetër që do ta respektoj. Sepse demokracia jeton edhe nga kjo e drejtë dhe nga respekti për këtë të drejtë. Por nëse një ditë do të kuptosh të vërtetën e thjeshtë, se halli yt nuk është asfale larg hallit tim, atëherë mos i prit aty ata që do të kthehen përsëri në mbrëmje.

Eja tek unë.

Jo të më duartrokasësh. Jo të heqësh dorë nga kritikata e tua. As të më votosh nëse nuk do të të mbushet mendja, se jo thjesht nuk jam unë e keqja e madhe që ata të kanë mbushur mendjen se jam, po unë sot jam e vetmja pengesë mes këtij vendi e teje dhe të këqijave të mëdha, që ata mund t'i bëjnë Shqipërisë po t'u hapet ruga.

Eja pra tek unë, qoftë edhe vetëm për të mos lënë askënd ta përdorë hallin tënd kundër Shqipërisë dhe as të përdorë hallin e Shqipërisë kundër teje. Eja, sepse Shqipëria nuk bëhet as me ata që brohorasin verbërisht, as me ata që zemërohen verbërisht. Shqipëria po bëhet nga çdo shqiptar e shqiptare, që në vend se të mallkojë errësirën ndez përditë qiriun e kontributit të vet, duke shtuar në çdo hap dritën e Shqipërisë Evropiane dhe pakësuar errësirën e trashëguar nga kohërat e vjetra e më të reja.

Kush do që drita të shtohet më shumë dhe errësira të tretet më shpejt është i bekuar, sado qoftë jo dakord me mua. Ndërsa ata që do të rikthehen sonte në mbrëmje për të përdorur trupin e mishin tënd, janë vetë errësira e një mallkimi të vjetër mbi Shqipërinë.

Unë jam miku, jo armiku yt.



Tirana, kryeqyteti i dytë më i shtrenjtë në Evropë

TIRANË, 23 QERSHOR - Derisa inflacioni dhe rritja e kostos së jetesës vazhdojnë të ushtrojnë presion mbi buxhetet familjare në të gjithë Evropën, përballeshmëria është bërë një nga çështjet ekonomike përcaktuese për qytetarin mesatar evropian.

Tirana është renditur në qytetin e dytë më të shtrenjtë në Evropë, teksa një familje, me katër persona me dy të rritur me rrogë mesatare shpenzon 89 % të të ardhurave për të bërë një jetesë normale, raporton Monitor.al. Në këto nivele,

Tirana renditet vetëm pas Lisbonës, që kryeson listën në Evropë me një nivel prej 1 2195.8%.

Të dhënat u bënë të ditura në një raport të fundit të Tradingpedia. Për të zbuluar se cilat kryeqytete ofrojnë standardin më të mirë të jetesës me barrën më të vogël financiare në raport me të ardhurat mujore, Tradingpedia krahasoi të dhëna nga 37 kryeqytete evropiane, duke marrë parasysh shpenzimet e përditshme dhe pagat mesatare neto mujore (paga

“reale” pasi zbriten të gjitha taksat dhe detyrimet nga paga bruto).

Raporti merr në konsideratë pagën neto, që për Shqipërinë është 760 euro në muaj dhe të ardhurat e familjes i llogarit në 1520 euro në muaj, duke supozuar që punojnë dy të rritur. Një shpenzim për një familje me katër persona llogaritet në 1 353 euro në muaj, për të cilin duhen shpenzuar gati 90 % e të ardhurave.

Shqipëria ka një kosto jetese shumë më të shtrenjtë sesa

vendet e tjera të rajonit. Në Shkup të Maqedonisë së Veriut, ku paga mesatare neto është në nivele të ngjashme me të Shqipërisë, në 769 euro në muaj, shpenzimet mujore për një familje me 4 persona janë 1037 euro, duke zënë 67 % të të ardhurave, shumë më pak sesa në Shqipëri.

Në Beograd, ku paga neto është 1 081 euro, pesha është 68.2 %, teksa shpenzimet mujore janë pak më të larta se në Tiranë duke arritur në 1 478 euro, por pagat neto janë rreth 30 % më të larta.



Në Podgoricë paga mesatare mujore neto është 883 euro, më e lartë sesa në Shqipëri dhe shpenzimet mujore janë më të ulëta në 1 077 euro, duke bërë që Sarajeva të jetë relativisht qyteti me koston më të ulët të jetesës në rajon, në raport me të ardhurat. Të dhënat për Kosovën nuk janë në këtë raport.

GUVERNATORI ISMAILI MERR PJESË NË CEF FORUM 2026 PËR QEVERISJEN, LIDERSHIPIN DHE QËNDRUESHMËRINË INSTITUCIONALE

SHKUP, 23 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në CEF Forum 2026, të mbajtur në Shkup, nën temën “Qeverisja në pasiguri dhe ndërtimi i institucioneve publike të qëndrueshme”.

Forumi mbledhi së bashku politikëbërës të nivelit të lartë, drejtues të administratës publike, përfaqësues të bankave qendrore dhe ekspertë ndërkombëtarë, për të diskutuar mbi lidhshimin, qëndrueshmërinë institucionale dhe qeverisjen efektive në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të pasigurt.

Para Forumit, guvernatori Ismaili mori pjesë, në cilësinë e vëzhguesit, në Takimin Vjetor të



Bordit Drejtues të Qendrës së Ekselencës në Financa (CEF), ku u diskutuan prioritetet institucionale, iniciativat në zhvillim dhe drejtimit e ardhshme për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe

zhvillimit të kapaciteteve. Në kuadër të Forumit, guvernatori Ismaili mori pjesë si panelist në sesionin “Qeverisja në pasiguri: zgjedhjet e lidhshimit nën presion”, krahas përfaqësuesve të lartë të

bankave qendrore dhe institucioneve publike nga rajoni. Diskutimi në panel u fokusua në lidhshimin nën presion, qëndrueshmërinë institucionale, balancimin e politikave, koordinimin dhe vendimmarrjen në kohë pasigurie.

Në fjalën e tij, guvernatori Ismaili theksoi se pasiguria është bërë tipar përcaktues i mjedisit të sotëm të politikëbërjes, duke kërkuar nga institucionet forcimin e kapaciteteve për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave ekonomike, financiare, teknologjike dhe gjeopolitike në zhvillim. Ai nënvizoi se qëndrueshmëria institucionale ndërtohet mbi qeverisjen e mirë, ekspertizën profesionale,

koordinimin efektiv, mësimin e vazhdueshëm dhe lidhshimin strategjik.

Duke reflektuar mbi përvojën e lidhshimit në kohë pasigurie, guvernatori Ismaili theksoi rëndësinë e vendimmarrjes në kohë, komunikimit transparent, përshtatshmërisë dhe besimit si elemente thelbësore për ruajtjen e kredibilitetit institucional dhe besimit publik.

Guvernatori Ismaili, gjithashtu, theksoi rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve, programeve për lidhshim, bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimit të njohurive dhe ushtrimeve të bazuara në skenarë krizash si mjete praktike për forcimin e përgatitjes dhe qëndrueshmërisë institucionale.

LANSOHET PLATFORMA PËR MBLEDHJEN DHE RAPORTIMIN E STATISTIKAVE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka organizuar aktivitetin me kompanitë raportuese, për prezantimin dhe lansimin e platformës së re DCSES (Data Collection and Statistics Exchange System), e cila do të shërbejë për mbledhjen elektronike të statistikave të investimeve të huaja direkte.

Në hapje të aktivitetit, zëvendës guvernatori i BQK-së, Dardan Fusha, falënderoi kompanitë raportuese për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në procesin e raportimit statistikor në BQK, duke theksuar se cilësia e statistikave zyrtare varet

drejtëpërdrejt nga cilësia dhe saktësia e të dhënave të raportuara.

Zëvendës guvernatori Fusha nënvizoi se investimet e huaja direkte përfaqësojnë një nga treguesit më të rëndësishëm të besimit të investitorëve në ekonominë e Kosovës dhe se cilësia e statistikave në këtë fushë ndikon drejtëpërdrejt në prezantimin e vendit para investitorëve ndërkombëtarë, institucioneve financiare dhe partnerëve zhvillimorë.

Platforma e re DCSES paraqet një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të procesit të mbledhjes së të dhënave në formë elektronike dhe raportimit statistikor në BQK.



Ajo është zhvilluar në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe kërkesat e

reja statistikore, përfshirë ato të Manualit të fundit BPM7, duke kontribuar në përafrimin e

mëtejshëm të sistemit statistikor të Kosovës me praktikën e ekonomive dhe institucioneve më të avancuara.

Për kompanitë raportuese, platforma e re do të mundësojë një proces më të thjeshtë dhe më efikas të raportimit, do ta shkurtojë barrën administrative, do ta përmirësojë saktësinë e të dhënave dhe do ta lehtësojë komunikimin ndërmjet raportuesve dhe BQK-së. Përmes automatizimit të proceseve dhe kontrolleve të integruara, pritet të shkurtohen nevojat për korrigjime të mëvonshme dhe procedurat manuale, duke kursyer kohë dhe burime si për kompanitë ashtu edhe për BQK-në.

OEK-u dhe KPKSh - PBM drejt një initiative për promovimin e produkteve kosovare në rrjetin hotelier të Kroacisë

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Hapja e tregjeve të reja për prodhuesit e Kosovës dhe forcimi i pranisë së produkteve vendore në rajon dhe Evropë ishte tema qendrore e takimit ndërmjet kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna dhe Gani Xharrahi, kryetar i Këshillit të

Pakicës Shqiptare të PBM - KPKSh-PBM.

Gjatë takimit u diskutua organizimi i një eventi të përbashkët që do të sjellë në një platformë prodhuesit e Kosovës dhe përfaqësuesit e sektorit hotelier në Rijekë, Opatija, Krk dhe zona të tjera, me synimin që

produktet e Kosovës të gjejnë rrugë konkrete për t’u bërë pjesë e ofertës së këtyre hoteleve.

Ky bashkëpunim synon të krijojë mundësi të reja për bizneset vendore, ta promovojë cilësinë e prodhimit të Kosovës dhe të ndërtojë lidhje të qëndrueshme ekonomike me

tregjet ndërkombëtare.

Oda Ekonomike e Kosovës mbetet e përkushtuar që përmes partneriteteve strategjike të mbështesë prodhuesit e Kosovës dhe ta çojë prodhimin vendor sa më thellë në tregun evropian dhe më gjerë.



NJERIU PËRBALLË PERËNDIVE: PSE PROMETEU, SIZIFI DHE ULIKSI U NDËSHKUAN PËR KRENARINË



Në mitologjinë greke, heronjtë admiroheshin për guximin, zgjuarsinë dhe vendosmërinë e tyre. Por ekzistonte një kufi që nuk duhej kaluar kurrë: sfida e drejtpërdrejtë ndaj perëndive dhe rendit që ato kishin vendosur.

Grekët e lashtë kishin një fjalë për këtë sjellje: hubris. Ajo përshkruante krenarinë e tepruar, arrogancën dhe bindjen se një njeri mund të ngrihej mbi kufijtë e natyrës, fatit apo vetë hyjnive. Në pothuajse të gjitha mitet e mëdha, ata që harronin vendin e tyre përfundonin duke paguar një çmim të rëndë.

Prometeu, Ikari, Sizifi, Belerofonti, Araknida dhe Uliksi janë vetëm disa prej figurave që sfiduan kufijtë e vendosur nga perënditë. Historitë e tyre mbeten aktuale edhe sot, sepse flasin për një dobësi universale njerëzore: dëshirën për të kapërcyer çdo kufi.

Hubris: mëkati që perënditë nuk e falnin

Për grekët e lashtë, problemi nuk ishte ambicia në vetvete. Problemi lindte kur ambicia kthehej në bindjen se njeriu ishte i barabartë me perënditë. Arroganca konsiderohej e rrezikshme sepse e bënte njeriun të harronte natyrën e tij të vdekshme. Kush e humbte këtë vetëdijë rrezikonte të shkelte ligjet, traditat dhe ekuilibrin mbi

të cilin mbahej rendi i botës. Pikërisht për këtë arsye, mitologjia është e mbushur me histori ndëshkimesh shembullore.

Prometeu: heroi që vodhi zjarrin për njerëzit

Asnjë figurë nuk mishëron më mirë konfliktin midis njeriut dhe perëndive sesa Prometeu.

Duke sfiduar vullnetin e Zeusit, titani vodhi zjarrin nga Olimpi dhe ua dhuroi njerëzve. Ky akt i lejoi njerëzit të zhvilloheshin, të ndërtonin qytetërimë dhe të fitonin njohuri.

Për grekët e hershëm, veprimi i tij ishte një shkelje e rëndë e rendit hyjnor. Ndëshkimi ishte brutal: Prometeu u lidh në një shkëmb në Kaukaz, ku një shqiponjë i çukiste çdo ditë mëlçinë, e cila rigjenerohej gjatë natës.

Megjithatë, me kalimin e shekujve, figura e tij ndryshoi. Nga rebel i dënuar, ai u shndërrua në simbol të dijes, progresit dhe guximit për të sfiduar autoritetin.

Araknida: kur talenti shndërrohet në krenari

Araknida ishte një qëndistare me talent të jashtëzakonshëm. Problemi i saj nuk ishte aftësia, por bindja se ishte më e mirë se vetë Athinaja, perëndesha e urtësisë dhe e artizanatit.

Kur sfidoi perëndeshën në një

garë, Araknida tregoi jo vetëm vetëbesim, por edhe përbuzje ndaj hyjnore.

Athinaja e ndëshkoi duke e shndërruar në merimangë, një simbol i përjetshëm i mjeshhtërisë së saj, por edhe i krenarisë që e çoi drejt rënies.

Orfeu dhe sfida ndaj vdekjes

Ndryshe nga heronjtë e tjerë, Orfeu nuk u shty nga ambicia apo dëshira për pushtet.

Ai sfidoi kufijtë e botës së të vdekurve për dashurinë e tij ndaj Euridikës.

Me muzikën e tij preku zemrat e Hadit dhe Persefonës, të cilët pranuan t'ia kthenin bashkëshorten. Kushti ishte i thjeshtë: të mos kthehej për ta parë derisa të dilnin nga bota e nëndheshme.

Por Orfeu dështoi. Në momentin e fundit u kthye dhe humbi Euridikën përgjithmonë.

Miti i tij shpreh një ide të lashtë: edhe dashuria më e madhe nuk mund ta mposhtë plotësisht vdekjen.

Sizifi: njeriu që mendoi se mund ta mashtronte vdekjen

Sizifi ishte një mbret i famshëm për zgjuarsinë e tij. Ai arriti të mashtronte jo vetëm njerëzit, por edhe vetë Vdekjen. Për një kohë,

askush nuk vdiste më në botë. Por sfida ndaj rendit natyror nuk mund të zgjaste përgjithmonë. Kur më në fund u kap, Sizifi mori një ndëshkim që është bërë simbol i absurditetit njerëzor: të shtynte një gur gjigant drejt majës së malit, vetëm që ai të rrokullisej sërish poshtë. Puna e tij nuk do të përfundonte kurrë.

Belerofonti dhe dëshira për të arritur Olimpin

Pas fitoreve dhe lavdisë së tij, Belerofonti filloi të besonte se meritonte vend mes perëndive. Hipur mbi Pegasin, kalin me krahë, ai vendosi të fluturonte drejt Olimp. Zeusi nuk e toleroi sfidën. Një insekt i dërguar prej tij mjaftoi që Pegasi ta rrëzonte kalorësin.

Belerofonti mbijetoi, por pjesën tjetër të jetës e kaloi i gjymtuar, i verbër dhe i harruar.

Ikari: simboli i ambicies pa kufij

Pak mite janë bërë aq të famshme sa ai i Ikarit. Babai i tij, Dedali, i kishte paralajmëruar qartë rreziqet: të mos fluturonte as shumë lart dhe as shumë poshtë.

Por sapo ndjeu lirinë e fluturimit, Ikari injoroi këshillën. Ai u afrua tepër pranë Diellit. Dylli që mbante krahët u shkri dhe ai ra në det. Historia e tij është bërë simbol universal i ambicies që

nuk njeh kufij.

Uliksi dhe etja e pangopur për dije

Në traditën greke, Uliksi ishte heroi i zgjuarsisë dhe këmbënguljes. Por në interpretimin e Dantes, ai shfaqet ndryshe. Etja e tij e pafund për të eksploruar dhe për të njohur botën e shtyn përtej kufijve të lejuar. Ai kalon përtej Kolonave të Herkulit, kufiri simbolik i botës së njohur.


Pikërisht kjo dëshirë e pangopur për dije bëhet arsyeja e humbjes së tij.

Pse këto mite vazhdojnë të na flasin edhe sot?

Prometeu, Ikari, Sizifi, Orfeu dhe Uliksi nuk janë thjesht personazhe të lashtësisë.

Ata përfaqësojnë pyetje që njerëzimi vazhdon t'i bëjë vetes: Deri ku duhet të shkojë ambicia? A ka kufij që nuk duhen kaluar? Çfarë ndodh kur njeriu sfidon natyrën? A është progresi një akt guximi apo arrogance? Prandaj këto mite kanë mbijetuar për më shumë se dy mijë vjet. Ato nuk flasin vetëm për perënditë e Olimp, por për vetë natyrën njerëzore.

Njeriu mund të sfidojë kufijtë, por çdo sfidë ka një çmim. Dhe shpesh, rreziku më i madh nuk është dështimi, por bindja se nuk mund të dështosh. / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Messi bëhet golashënuesi më i mirë në historinë e Kupës së Botës

Dallas, 23 qershor - Lionel Messi ka shkruar një tjetër kapitull historik në futbollin botëror, duke u bërë golashënuesi më i mirë në historinë e Kupës së Botës. Kapiteni i Argjentinës ka arritur shifrën e 18 golave në turneun më të madh të

futbollit, pas dy golave të shënuar ndaj Austrisë. Me këtë arritje, Messi ka kaluar legendën gjermane Miroslav Klose, i cili mbante rekordin me 16 gola, duke u vendosur në krye të listës së golashënuesve më të mirë të të gjitha kohëve në Botëror.

Ky rekord vjen në një periudhë të jashtëzakonshme për yllin argjentinas, i cili vazhdon t'i udhëheqë kampionët e botës në kërkim të një tjetër triumfi. Pas tij në garën për këtë rekord është kapiteni i Francës, Kylian Mbappë, i cili

deri tani ka shënuar 16 gola në Kupën e Botës dhe mbetet një nga kërcënuesit kryesorë për rekordin e Messit. Me këtë paraqitje, Messi po e forcon edhe më shumë statusin e tij si një nga futbollistët më të mëdhenj në historinë e këtij sporti.



FFK-ja THEMELON AKADEMINË E REFERIMIT TË KOSOVËS



Prishtinë, 23 qershor - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me Shoqatën e Gjyqtarëve të Kosovës, do të nisë zyrtarisht më 1 korrik Akademinë e Referimit të Kosovës, një projekt i rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e gjyqtarëve të reja të gjyqtarëve të futbollit. Qëllimi i akademisë është identifikimi, edukimi dhe përgatitja profesionale e gjyqtarëve të rinj, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për

të ardhmen e referimit në Kosovë. Ligjërues dhe mentorë të akademisë do të jenë gjyqtarët me stemë të FIFA-s, Fatlum Berisha, Besnik Morina dhe Bujar Selimaj, si dhe ish-gjyqtari Kreshnik Vula, të cilët do ta ndajnë përvojën dhe ekspertizën e tyre me gjeneratat e reja të arbitrave. Projekti do të udhëhiqet nga kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës, Përparim Hasani, i cili ka qenë iniciatori dhe mbështetësi kryesor i këtij programi

zhvillimor. Sipas njoftimit, të gjitha informatat lidhur me procesin e rekrutimit, kriteret e aplikimit dhe mënyrën e regjistrimit do të publikohen nga 1 korriku përmes kanaleve zyrtare të FFK-së dhe Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës. Themelimi i Akademisë së Referimit të Kosovës konsiderohet hap i rëndësishëm drejt ngritjes së cilësisë së referimit dhe krijimit të mundësive të reja për të rinjtë që synojnë të ndërtojnë karrierë në futboll.

XHAKA KRYESON, MESFUSHORI MË I MIRË I BOTËRORIT NË PASIMET NËN PRESION

Faqja e specializuar e statistikave, "Gradient Sports", ka publikuar renditjen e futbollistëve me performancën më të mirë në pasimet e realizuara nën presion gjatë fazës së grupeve të Kupës së Botës 2026. Sipas analizës së 36 ndeshjeve të para të turneut, vendin e parë e mban mesfushori i Zvicrës, Granit Xhaka, me 91.8 pikë. Kapiteni i Zvicrës është vlerësuar lojtari më i saktë dhe më efektiv

në shpërndarjen e topit në situata të vështira, kur kundërshtarët ushtrojnë presion të drejtpërdrejtë. Pas tij renditet mesfushori i Spanjës, Rodri, me 90.8 pikë. Ylli spanjoll vazhdon ta konfirmojë reputacionin e tij si një nga organizatorët më të mirë të lojës në futbollin botëror, duke qenë vendimtar në kontrollin e ritmit të ndeshjeve. Në vendin e tretë surprizon mbrojtësi qendror i Zvicrës, Manuel Akanji, me 88.2 pikë.



Futbollisti i Manchester Cityt ka treguar qetësi dhe saktësi të jashtëzakonshme në ndërtimin e aksioneve nga prapavija. Top pesëshja plotësohet nga

koreano-jugori Lee Kang-in, i katërti me 87.3 pikë, dhe mbrojtësi i Turqisë, Zeki Çelik, i cili ka grumbulluar 86.1 pikë. Ndër emrat më të spikatur në listë është edhe mesfushori i Barcelonës dhe Spanjës, Pedri, që renditet në vendin e gjashtë me 84.9 pikë. Kjo statistikë nuk mat thjesht saktësinë e pasimeve, por vlerëson cilësinë e tyre në momente kur lojtarët janë nën presionin e kundërshtarëve, duke u

konsideruar tregues i rëndësishëm për aftësinë e një futbollisti për ta kontrolluar lojën dhe për të marrë vendime në situata të vështira. Paraqitjet e Xhakës, Rodrit dhe Akanjit kanë qenë ndër faktorët kryesorë që Zvicra dhe Spanja kanë shfaqur një nivel të lartë organizimi në fazën e grupeve, ndërsa renditja konfirmon edhe një herë rëndësinë e lojtarëve që diktojnë ritmin e lojës nga mesfusha dhe prapavija.

KEPI I GJELBËR, MREKULLIA E KUPËS SË BOTËS - VLEN MË PAK SE ÇDO SKUADËR E LA LIGËS, POR PO MAHNIT BOTËN



MIAMI, 23 QERSHOR - Një nga historitë më të bukura të Kupës së Botës 2026 po shkruhet nga Kepi i Gjellbër. Përfaqësuesja afrikane ka befasuar botën e futbollit me paraqitjet e saj, pas rezultateve pozitive ndaj Spanjës

dhe Uruguait, duke u kthyer në një nga surprizat më të mëdha të turneut. Ajo që e bën edhe më të veçantë këtë sukses është fakti se vlera totale e skuadrës së Kepit të Gjellbër është më e ulët se ajo e çdo ekipi që garoi në sezonin

2025/26 të La Liga. Vlera e tregut e kombëtares afrikane llogaritet rreth 54.5 milionë euro, një shifër modeste krahasuar me shumicën e kundërshtarëve në Kupën e Botës në ShBA, Meksikë dhe Kanada.

Megjithatë, në fushë Kepi i Gjellbër ka treguar krejt të kundërtën. Një rezultat pozitiv ndaj Arabisë Saudite mund t'i hapë rrugën kualifikimit historik në fazën eliminatorë të Botërorit.

Prishtina Padel Open 2026 përfundon me sukses

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Prishtina ka pritur edicionin e katërt të turneut ndërkombëtar Prishtina Padel Open 2026 i cili është zhvilluar në Padel Zone. Rreth 60 lojtarë nga rajoni dhe

Evropa kanë marrë pjesë në garë, ndërsa titullin e kampionit e kanë fituar Gjorgji Jankulovski nga Maqedonia e Veriut dhe Lars Hordijk nga Holanda. Dyshja e Kosovës, Shkëlzen

Llapiashtica dhe Lorik Rexhepi, kanë arritur deri në finale, ndërsa vendin e tretë e kanë siguruar Fresk Sylhasi dhe Art Grubi. Organizatorët kanë vlerësuar

nivelin e garës dhe pjesëmarrjen ndërkombëtare, duke theksuar se turneu po kontribuon në rritjen dhe zhvillimin e padelit në Kosovë dhe rajon.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Eling Group" Sh.p.k., Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun fotovoltaik Eling, 6 MW - sistemi solar me pajisje fotovoltaike me fuqi të instaluar prej DC 6165 KVP në Llabjan, Komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.08.2026 në ora 11:00 në objektin e Kosova Innovation Hub, Çamila Sijarića, Vitomiricë, Pejë, do të organizohet debat publik nga "Eling Group" Sh.p.k., Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

- **Linku i takimit:**
<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wvqrcGJk62TC60ZORNyqoJzhk>
- **Meeting ID:** 953 525 7790
- **Passcode:** 000000


Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Eling Group" Sh.p.k., Prishtinë për Pëlqim Mjedisor për Parkun fotovoltaik Eling, 6 MW, në Llabjan, Komuna e Pejës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- I Argjendi Grill SH.PK. shpall të pavlefshme numrin e TVSH-së, me nr. 330626616 të lëshuar nga ATK.
- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.
- Arnit Dervishi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.
- Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.
- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.
- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.
- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.
- "Restorant te Besi" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.
- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.
- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.
- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.
- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. "Ibrahim Fehmiu" Prizren.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.
- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

F2.3/BNJ-KP/PT



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokollit 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokollit 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokollit 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Komunes së Fushë Kosovës dhe KRM Pastrimi me nr. të protokollit 02/01/311 të datës 02.06.2026 bazuar në Vendimin e datës 17.06.2026 me numër të protokollit 02/01/343 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: Shofer i Kategorisë C dhe C1
 Nr. i kërkuar: Pesë (5) pozita, NJO Fushë Kosovë në KRM "Pastrimi" SH.A
 Numri i Referencës: KP/PT/NJOFSH/12-2026
 Koficienti/Paga mujore: Niveli XI
 Përvoja e punës: 1 vite përvojë pune, e dëshiruar dhe përparësi aplikimi
 Periudha Provuese: 3 muaj
 Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të caktuar

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Nget automjetin sipas urdhërësës së punës në rajonin që i është përcaktuar nga udhëheqësi;
- Është përgjegjës për udhëtoje nëpër rrugët dhe zona të caktuara për të mbledhur mbeturinat në mjediset e tyre të vendosura sipas planifikimit të kompanisë;
- Kontrollojë mjedisin për të identifikuar mbeturinat që duhet të merren dhe për të siguruar që puna bëhet sipas rregullave të shëndetit dhe sigurisë duke mos penguar komunikacionin;
- Në bashkëpunim me udhëheqësin planifikon rrugët më të efektshme për të mbledhur mbeturinat nga zona që i është caktuar për të minimizuar humbjen e kohës dhe ruajtjen e kostos dhe udhëtimit;
- Është përgjegjës për të siguruar që automjeti të jetë i sigurt dhe i gatshëm për përdorim përfshirë në kontrollin e nivelit të karburantit, kontrollin e presionit të gomave dhe kujdesin e përgjithshëm të automjetit.
- Shoferi duhet të sigurojë që mbeturinat e cilësuar si shpërthyes të vendosen dhe të transportohen me kujdes të veçantë, duke zbatuar rregulloret mbi mbeturinat e rrezikshme;
- Raporton çdo situatë të jashtëzakonshme që ndodh gjatë detyrës përfshirë emergjenca, dëmtime të automjetit ose shkelje të sigurisë;
- Kujdeset dhe i respekton rregullat e komunikacionit rrugor;
- Mbanë regjister të përgjegjshmërisë, në përputhje me rregulloret dhe politikat e kompanisë.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë;
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njesisë Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- Aftësia për të punuar vetë;
- Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- Njohuri për sigurinë publike;
- Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

4.1 Dokumente të veçanta

- Patentë shoferi obligator për shoferët e kategorisë: B, C dhe C1

4.2 Forma e Konkursit Publik pa test (KP/PT):

-Konkursi për këtë pozitë zhvillohet me procedurë të veçantë, pa testim me shkrim dhe përfshin vetëm vlerësimin e CV-së dhe intervistën profesionale.

5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
 * në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
 * Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 24/06/2026 deri me datën 08/07/2026.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poenimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

9. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ardita" SH.P.K. Shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit me nr. 810232546 të lëshuar nga ARBK.

Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

